




REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA/REPUBLIC OF KOSOVO

KOMUNA E GJILANIT
OPŠTINA GNJILANE/MUNICIPAL GJILAN/GILAN BELEDIYESI



Adresa: rr. "Adem Jashari" pn, kk.rks-gov.net gjilan, indo.gjilan@rks-gov.net tel. 0280 320 781, 0280 320 782, 321 482, 321 483

Procesverbal

I mbajtur në seancën e njëmbëdhjetë (XI) të Kuvendit të Komunës së Gjilanit, më datë 24.09.2013 me këtë:

R E N D P U N E

1. Konstatimi i prezencës dhe miratimi i procesverbaleve nga seanca e IX, X dhe seanca e jashtëzakonshme,

2. Rekomandimet e Komitetit për Politikë dhe Financa:

- 2.1. Propozim Buxheti i Komunës së Gjilanit për vitin fiskal 2014 dhe vlerësimet e hershme për vitet 2015-2016,
- 2.2. Draft Rregullorja për implementimin e tatimit në pronë për vitin fiskal 2014,
- 2.3. Propozim vendimi për lejimin e ridestinitimit të mjeteve financiare,
- 2.4. Strategjia Lokale kundër dhunës në familje 2013-2018,
- 2.5. Propozim vendimi për lejimin e këmbimit të pronës së paluajtshme komunale me pronën e paluajtshme private për nevojat e rrugës publike "Jugu I-pjesa e II-të, (rasti i familjes Haziri),
- 2.6. Propozim vendimi për lejimin e ri-rregullimit të kufijve të ngastrave kadastrale komunale me ato private për nevojat e rrugës publike,
- 2.7. Propozim vendimi për lejimin e këmbimit të pronës së paluajtshme komunale me pronën e paluajtshme të Bashkësisë Islame-Xhamia e Deremahallës,
- 2.8. Propozim vendimi për ndërrimin e destinimit të PZHU-ndërtimi i Xhamisë në Lagjen "Z.S.Agës".
- 2.9. Marrëveshja e Mirëkuptimit në mes të Komunës së Gjilanit, Qendrës Socio-Kulturore "Don Bosko" dhe Kryefamiljarit z.Selim Ramadani nga Gjilani,

3. Të ndryshme,

Kryesuesi i Kuvendit
Izmi Zeka

Në punimet e seancës së nëntë morën pjesë:
Anëtarët e Kuvendit,
Drejtorët e drejtorive
Përfaqësuesi i OSB-së, z. Irfan Ukshini
Përfaqësuesi i Shoqërisë Civile Shaban Terziu
Përfaqësuesi i KVRL-së
Fadil Isufi-përfaqësues i UNKT (Kombet e Bashkuara)
Mediet

Seancën e njëmbëdhjetë e hapi dhe udhëhoqi, kryesuesin i Kuvendit, z. Izmi Zeka i cili i përshëndeti të pranishmit, dhe theksoi se kjo do të jetë seanca e fundit për këtë mandat qeverisës, kurse pas 4-5 ditë do ta mbajmë një seancë solemnet për ta përmbyllur punën katër vjeçare të KK-së.

1. Konstatimi i prezencës dhe miratimi i procesverbaleve nga seanca e IX, X dhe seanca e jashtëzakonshme

Nga ana e sekretarisë u konstatua se në punimet e seancës së njëmbëdhjetë ishin të pranishëm të gjithë anëtarët e Kuvendit (41).

Izmi Zeka- materialet i kanë marrë të gjithë anëtarët, rendi i punës është rekomanduar nga KPF, por nëse ka ndonjë kërkesë për plotësim ose ndryshim mund ta propozoni.

Refik Hasani- së pari kam një kërkesë që vendimi i datës 26.7.2013 për formimin e komiteti, të zbatohet dhe të zgjidhen anëtarët e këtij komiteti shumë me rëndësi dhe menjëherë të fillojë me punë për përgatitjen ligjore mbi përgatitjen e Draft marrëveshjes për bashkëpunim ndërkufitar në fusha të caktuara me komunat e Kosovës Lindore dhe të Kumanovës dhe Likovës.

-Kërkesë tjetër të cilën e kemi bërë me shkrim dhe të cilën po e paraqes edhe në këtë seancë është që të shqyrtohet mundësia për ta caktuar një zyrtar për evidentimin e të gjithë qytetarëve të shpërngulur nga Kosova Lindore dhe t'iu mundësohet që të pajisen me dokumente të nevojshme.

- Kërkesa e tretë është që të aprovohet një vendim ose të nxirret një konkluzion që niveli Komunal, KK i Gjilanit t' i rekomandojë Kuvendit dhe Qeverisë së Kosovës që banorët e zhvendosur dhe të dëbuar nga trojet e veta, pas qershorit të vitit 1999 nga (Kosova Lindore), që këta banorë të regjistrohen si banorë të Komunës së Gjilanit.

Arben Mehmeti- sa i përket rendit të punës mua më duket se është jo serioze që në seancën e fundit kur duhet të diskutohet projekt- buxheti, ka edhe shumë pika të tjera, por ne kemi edhe pika shtesë për debat, sepse janë të rëndësishme së veçantë.

Mirëpo ne lidhur me këtë rend të punës e kemi dhënë mendimin tonë edhe në KPF për disa pika e për të cilat përsëri edhe në Kuvend e kemi të njëjtin qëndrim.

Kjo është një seancë shumë ngarkuar dhe ka pika të rendit të punës të cilat duhet të trajtohen ndryshe dhe jo në ditën e fundit të kësaj qeverisje, por duhet të lihen në ditën e parë të qeverisjes së ardhshme, sepse janë vendime të rëndësishme dhe janë interesa të rëndësishme të qytetarëve. Ky rend i punës është tepër i ngarkuar dhe joserioz për kohën për të cilën po diskutojmë. Është seanca e fundit e këtij mandati dhe sot ka qenë desh të debatohet për gjëra periferike dhe për gjëra të cilat më tepër janë gjëra teknike, sepse nuk duhet vërë qytetarin para një akti të mashtrimit kinse në seancën e fundit po e afrojmë një alternativë për këto zgjidhje e cila për mua është shumë jo serioze.

Kryesuesi i Kuvendit duhet t' i lënë çështjet për diskutim të cilat janë serioze t' i lënë për mandatin e ardhshëm. Të gjitha pikat ku ka reflektime financiare nuk duhet të debatohen, por duhet të shqyrtohen në mandatin e ardhshëm, sepse Komuna e Gjilanit është në bankrotim total financiar, është si ndonjë kompani e falimentuar e cila nuk ka mundësi për të bërë zgjidhje punëtorëve të vetë, kurse mos të bëhet fjalë për qytetarët e tjerë.

Për këtë arsyeje unë kërkoj që të gjitha ato pika që kanë reflektime financiare të shtyhen për seancën e radhës, sepse nuk do të shkojë gjatë dhe ajo do të mbahet. Prej të gjitha pikave me përjashtim të asaj për aprovim të buxhetit, nuk kemi ndonjë pikë tjetër e cila kërkon urgjencë të madhe.

Sokol Haziri- ne kur e kemi marrë mandatin e kemi marrë për ta përfunduar këtë mandat në mënyrën më të mirë të mundshme, kurse tash njerëzve të cilët radhiten nëpër parti të ndryshme politike iu u uroj që jenë mirë dhe rahat dhe është çështje personale se kush nga lëviz. Mirëpo tash është fundi i këtij mandati dhe nuk dua që ta ashpërsoj fjalorin politik ndaj askujt dhe uroj që të gjithë të punojmë bashkë dhe të jemi në shërbim të qytetarëve.

Është e vërtetë se rendi i punës është mjaft i ngarkuar, por shpresoj se nuk janë arsyeje politike, por janë arsye për të punuar më shpejtë në dobi të qytetarit.

Buxheti është kategori ligjore e cila kërkon afate, kurse edhe pikat tjera i kemi rekomanduar për aprovim në Kuvend edhe në KPF e të cilat duhet t' i debatojmë sot.

Një çështje të cilën unë e kam shtruar dhe e cila nuk është në rend të punës është çështja e një raporti për gjendjen në "Eco-higjienë". Si material nuk e kemi, por do të ishte mirë që edhe si informatë gojore ta dëgjojmë në këtë Kuvend?

Izmi Zeka- informata për "Eco- higjienën" do të epet në fund të seancës.

Arben Maliqi- unë dëshiroj që ashtu si na ka hije ta përfundojmë edhe këtë seancë ashtu si kemi filluar dhe mos të përdorim fjalor jo kuvendar. Jam i mendimit se këtu nuk ka asgjë të ngutshme dhe duhet të procedojmë sikur të ishte seanca e dytë apo e tretë dhe duhet të punojmë për të mirën e qytetarëve. Çështja e buxhetit është e obligueshme dhe duhet patjetër sot ta procedojmë, kurse sa i përket gjërave tjera mund të bisedojmë.

Mirëpo iu lus që sot në mënyrë dinjitoze ta përfundojmë këtë seancë dhe ta përfaqësojmë Komunë tonë si është më së miri, t' i lëmë anash të gjitha mosmarrëveshjet individuale, sepse jemi para medieëve dhe ta përfundojmë këtë mandat si është më së miri.

Bahrie Veseli- unë po e paraqes një preokupim timin, por ky është edhe shqetësim i të gjithëve, sepse po ndodh në Komunën tonë. Është fjalë për diskriminimin gjinor i cili po

bëhet çdo ditë nga ana e atyre të cilët e kanë pushtetin. Këtë po e argumentoj me rastin i cili ka ndodhur në Shkollën Filllore “Selami Hallaçi” me një arsimtare e cila është një ndër arsimtarët më të dalluara e që ajo është zonja Dritë Kallaba. Kërkoj që të më epen sqarime se çka ka ndodhur me këtë arsimtare ? Mandej është rasti i zonjës Luljeta Hoxha e cila e ka një përvojë 25 vjeçare e cila është larguar nga puna e që është absurde dhe diskriminim gjinor, por edhe shkelje e të gjitha të drejtave elementare njerëzore. Nuk ka mundësi që një numër i caktuar i prindërve të bëjë kërkesë (ndoshta është edhe montim), të bëjë kërkesë për përjashtimin e një arsimtareje, sepse të njëjtit nuk kanë të drejtë për ta zgjedh arsimtarin. Mandej është rastin në shkollën në Lagjen e Tetë, ku zonja Rexhie Bllaca e cila ka qenë duke punuar, por në vend të saj është pranuar dikush tjetër, kurse zonja Bllaca tash është e sëmurë. Kërkoj që të keni kujdes se si silleni me qytetarin kur jeni në pushtet dhe si e shfrytëzoni atë drejtë. Kërkoj që këtë shqetësim ta bartini aty ku duhet sidomos kryetari dhe të ndëshkohen njerëzit të cilët bëjnë padrejtësi të tilla ! Kërkoj që politika të ndahet nga arsimi dhe të ngritët zëri sidomos ndaj atyre që i shkelin të drejtat e gruas.

Saranda Bllaca- disa nga nxënësit e Gjimnazit më kanë shkruar në adresën time elektronike dhe janë ankuar se disa mësimdhënës të cilët janë kandidatë për anëtarë të Kuvendit, kanë filluar të bëjnë fushatë elektorale në veçanti me maturantë. Ata mësimdhënës i pyesin nxënësit sa vjet i kanë dhe a janë votues, pastaj e kërkojnë votën.

Unë kërkoj nga DA që t’ia tërheq vërejtjen të gjithë mësimdhënësve të cilët janë kandidatë për anëtarë të Kuvendit që mos të bëjnë këso manovrime, sepse në të kundërtën do të dal edhe me emra. Mirëpo për hir të korrektësisë kësaj radhe do t’i kursej.

Unë i posedoj edhe dëshmitë e nxënësve, por nuk do t’i them për arsyeje që e thash më parë.

Izmi Zeka- në të ndryshme janë përgjegjësit këtu dhe këto që i kërkuat ata do të japin sqarime, por edhe informata për “Eco- higjienën”

E keni rendin e punës dhe të deklaroheni se kush është për aprovim të këtij rendi të punës?

Aprovohet rendi i punës me 24 vota të anëtarëve të Kuvendit, kurse 16 abstenuan

Izmi Zeka- në këtë seancë i kemi tri procesverbale për t’i aprovuar, sepse ka qenë koha e pushimeve, prandaj nëse ka vërejtje në procesverbale të deklaroheni?

Aprovohen procesverbalet në parim, por nëse ka vërejtje mund të dërgohen me shkrim edhe në sekretari.

2. Rekomandimet e Komitetit për Politikë dhe Financa:

2.1 - Propozim Buxheti i Komunës së Gjilanit për vitin fiskal 2014 dhe vlerësimet e hershme për vitet 2015-2016,

Nuhi Nuhiu- kjo kornizë duhet të analizohet dhe studiohet mirë dhe secili anëtarë i Kuvendit është mirë për ta dhënë kontributin e tij. Ne qysh në muajin prill i kemi marrë nga Ministria e Financave, Kornizën afatmesme të shpenzimeve dhe mandej në maj

Kornizën afatmesme buxhetore dhe menjëherë e kemi shpërndarë nëpër drejtoritë komunale. Të gjithë drejtorët dhe njësitë e kësaj lëmie kanë marrë pjesë në hartimin e kësaj kornize buxhetore. Mirëpo sido që të jetë kjo ka qenë desh që sot përmes propozimeve dhe sugjerimeve të anëtarëve të Kuvendit të plotësohet dhe pasurohet edhe më mirë dhe për tri vitet e ardhme ta kemi një kornizë të hartuar sa më mirë.

Pas marrjes së opinioneve nga drejtoritë ne e kemi bërë hartimin e kësaj e që edhe ju sot do të ndihmoni që kjo kornizë afat-mesme të plotësohet dhe të jetë edhe më e kompletuar. Sa i përket kufijve buxhetor, po vërehet se e kemi një ndryshim shumë të vogël sa i përket buxhetit të vitit 2013. Mirëpo vitet e ardhshme nuk do të thotë se do të mbesin me këtë buxhet, do të kemi rritje.

Buxheti i vitit 2013 ka qenë 18 milion 418 e 682 euro, kurse buxheti i këtij viti është 19.90% më i lartë se ai i vitit paraprak. Nëse pyet dikush se a jemi të kënaqur me këtë buxhet, lirisht mund të themi se jo! Këtë po e them, por e kam thënë edhe më parë se ky nuk është buxhet zhvillimor nuk ka të bëjë me zhvillimin, por është një buxhet i mbijetesës. Se si ndërtohet buxheti është e ditur, por Qeveria e ka vështirë ta bëjë një buxhet ashtu si ne kemi nevojë, sepse të gjitha të hyrat që i grumbullon Qeveria e Kosovës, vijnë nga doganat, nga tatimi dhe taksat, kurse nga prodhimi janë shumë pak mjete. Janë të dhënat në pasqyra tabelare në mënyrë makro ekonomike dhe mirkro-ekonomike. Në të hyra makro- ekonomike ne si Qeveri Komunale nuk mund të ndikojmë.

E kemi edhe një kategori tjetër të kategorisë e pagave, në të cilin kod ne si qeveri komunale, nuk mund të ndërhyjmë dhe të stafi i zyrtarëve, kurse të kodet e tjera duke filluar nga mallrat dhe shërbimet, subvencionet dhe komunalit dhe investimet kapitale ne si qeveri komunale mund të bëjmë ndryshime, por brenda kornizës, sepse vetë fjala kornizë do të thotë që diçka është e kufizuar.

Buxheti i Komunës së Gjilanit është i ndarë si të gjitha komunat e tjera në bazë të formulës e cila përdoret në tërë Kosovën. Këtë vit jemi në kufij të vitit 2011 kur është bërë regjistrimi dhe kemi një ndryshim të buxhetit krahasuar me vitet e tjera.

Te pagat kemi rritje 1.78%, te mallrat dhe shërbimet 21.54% në bazë të asaj që e kemi propozuar ne si drejtori, te komunalit i kemi 30.36% dhe arsyet janë për shkak të ngritjes së çmimeve, kurse te subvencionet e kemi një zbritje në krahasim me vitin e kaluar.

Te investimet kapitale kemi rritje 24.85% në krahasim me vitin e kaluar. Këto mjete prej 4 milionëve nuk mjaftojnë, por këto mjete i kemi, por sa i përket të hyrave vetanake duhet të angazhohemi që të bëjmë inkasim sa më të mirë. Te të hyrat vetanake e kemi një rritje prej 3 milion e 600 mijë në 3 milion e 750 do të thotë mbi 5% rritje. Mirëpo duhet pasur kujdes se tash e tutje nuk do të ketë leje të ndërtimit, sepse ajo do të kompensohet me infrastrukturë, por po ashtu do të jetë edhe me gjobat në trafik, sepse në vitet e mëparshme nga 400 mijë euro kemi pasur të hyra, por tash me ndërrim të ligjit nuk bëhen dënimet mandatore, por procedura shkon në gjykatë, kurse ne e dimë se si gjykata i zvarrit lëndët.

Në kategoritë e tjera të hyrat janë në nivelin e duhur dhe besoj se Komuna e Gjilanit ka kapacitete që t' i realizoj deri në 5 milion të hyra vetanake.

Zijadin Maliqi- gjatë analizës që kam bërë për buxhetin 2013 dhe kornizës afat mesme të vitit 2015 dhe 2016, kemi bërë një krahasim në këtë kornizë dhe në të cilën ne i kemi dhënë vërejtjet tona. Nga të gjitha analizat që i bëmë konstatuam se të hyrat janë të njëjta, kurse tek shpenzimet kemi një ndryshim të vogël edhe ai ndryshim është tek

pagat, kurse ka rritje te mallrat dhe shërbimet. Ne i kemi dhënë vërejtjet tona dhe kemi theksuar se kodi i mallrave dhe shërbimeve në kushte normale janë mjaft të rritura ose sipas përqindjes afër 20%. Te investimet kapitale kemi një rritje të vogël, por te mallrat dhe shërbimet dhe shpenzimet komunale kemi rritje më të madhe. Mirëpo po theksoj se ka qenë mirë që para aprovimit të buxhetit që ne si KK, t' i dimë obligimet sa i kemi? Këtë duhet ta dimë patjetër, sepse duhet të dimë për ta orientuar buxhetin.

Nëse ka obligime për mallra dhe shërbime, atëherë duhet të ndajmë obligime te mallrat dhe shërbimet, sepse ato obligime kjo Komunë duhet t' i kryejë dhe nuk i kryen askush tjetër. Në raportin gjashtë mujor drejtori thotë se shpenzimet janë në kufij normal, por unë e kam vërejt se shpenzimet nuk janë në kufijtë normal. Këtë po e them se në raportin gjashtë mujor, mallrat dhe shërbimet janë shpenzuar 99% dhe kanë mbetur vetëm 1 mijë 800 € për pa u shpenzuar. Te investimet kapitale me 6 mujor janë shpenzuar të gjitha, por janë edhe obligime diku mbi 500 mijë €. Është mirë që ta orientojmë buxhetin në ato pozicione ku kemi obligime. Në formën si është paraqit ky buxhet është vështirë për ta aprovuar një buxhet të tillë, sepse sipas meje nuk është në nivelin e duhur. Në këtë buxhet nuk shohim investime të reja, sepse kryesisht buxheti është paraparë që të shpenzohet në mirëmbajtje në sanime dhe të tjera, kurse vetëm 600 mijë € janë paraparë për disa projekte të cilat janë në participim me dhuruesit e huaj. Unë e konsideroj se ky buxhet nuk është në nivelin e duhur.

Sokol Haziri- ne në emër të grupit i kemi paraqit qëndrimet tona në KPF, por edhe në këtë seancë i kemi të njëjtat qëndrime. Ky nuk është buxhet i zhvillimit, por është një buxhet i vendnumërimit dhe nuk është një buxhet i cili siguron perspektivë zhvillimore. Sidoqoftë mbetet që të shpresojmë që të ketë rritje nga grandet qeveritare, por edhe rritje nga të hyrat vetanake në të ardhmen.

Ne në KPF kemi kërkuar që të bëhet një korrigjim sado i vogël dhe që nga kodi i mallrave dhe shërbimeve të barten mjetet nga ajo që quhet zhvillim (në kuptim të asaj që quhet investime kapitale).

Arben Mehmeti- mua më ka lënë mbresë më tepër një qëndrim i kryesuesit të KK të Gjilanit, z. Zeka, sepse në KPF ka deklaruar se Komuna e Gjilanit askujt nuk i ka borxh?

Këtë deklaratë, z. Kryesuesi i e ka thënë disa herë, mirëpo do të ishte mirë të na e sqaroj përfundimisht për herë të tretë ose të katërt para kamerave dhe duhet të evidentohet në procesverbal, sepse është mirë edhe për qytetarët e Gjilanit dhe për qeverisjen e ardhshme të LDK-së ta kenë situatën zero-zero si ka deklaruar kryesuesi i Kuvendit.

Unë e di që borxhe ka ndaj njerëzve që janë në Kuvend, në cilësi të trupave të Kuvendit dhe komisione të ndryshme. Është mirë që kryesuesi i Kuvendit të deklarojë publikisht sa ka borxh Komuna, sepse deklaratimet publike kanë një rëndësi të veçantë.

Unë kërkoj nga drejtori për Buxhet dhe Financa dhe kryetari i Komunës që të na jep verdiktin final, se Komuna e Gjilanit sa ka borxh, cili është obligimi, cilat janë projektet e papërfunduara dhe çfarë vlere financiare kanë ato projekte. Kjo është me shumë rëndësi, sepse ne duhet të ikim nga ky mandat me këtë informatë të plotë, sepse kryesuesi e ka krijuar një mjegull të plotë Komunës së Gjilanit, por edhe operatorëve të cilëve i kemi obligime si Komunë.

Izmi Zeka- unë po them se demokracia e ka këtë që secili mund të flet si të dojë dhe si t'ia merr mendja! Nëse asgjë nuk kemi bërë në këtë Kuvend është ajo se e kemi krijuar një atmosferë pune dhe ia kemi dhënë mundësinë edhe opozitës të flas edhe atëherë kur nuk e ka vendin dhe për gjëra shumë të pavërteta! Transparenca e madhe në KK, ka bërë që nganjëherë edhe të thumbohemi. Ne çdo detal dhe cent ia ofrojmë qytetarëve dhe anëtarëve të Kuvendit, por opozita kapet pas disa gjërave periferike.

Unë e kam thënë në KPF, por po e përsëris para drejtorit dhe kryetarit të Komunës, e kam thënë Komuna e Gjilanit nuk ka borxh asnjë cent! Këtë e kam thënë tekstualisht, por nëse ka kaluar procedura e tenderimit dhe janë dhënë 20%, puna nuk është kryer e cila punë edhe ka mundur edhe të ndërprehet dhe ne i kemi konsideruar edhe ato obligime të atij tenderi. Ne e kemi konsideruar atë tender të plotë p.sh 200 mijë € dhe kemi thënë është obligim, por nuk ka përfunduar puna. Kur të përfundojë puna, atëherë e konsiderojmë si obligim të Komunës.

Ju lus që mos ta keqpërdorni Kuvendin, sepse po dëgjohej se po bankroton Komuna dhe ju lus mos e keq informoni kryetarin e juaj të LDK-së, sepse ai fare nuk është në ngjarje.

Nuhi Nuhiu- sa i përket pyetjes së Zijadinit për shpenzim të buxheti qysh në muajin qershor 90%. Zijadini duhet ta dijë mirë se buxheti nuk mund të harxhohet si të duam ne dhe kur të duam ne? Është kesh plani dhe rrjedha e parasë i cili përcillet nga ministria dhe nga thesari. Planifikimi ka qenë i tillë që shpenzimet të rrjedhin gjatë 6 muajve të parë. Ne pa grumbulluar mjete nuk mund të shpenzojmë. Nëse neve na vjen një sasi e mjeteve tash duhet t' i shpenzojmë dhe jo në muajin e gjashtë ose të pestë.

Te mallrat dhe shërbimet kemi planifikuar më tepër, sepse në këtë kod kemi obligime, kurse obligime të investimet kapitale nuk kemi fare. Obligime kemi të shpronësimi, shpronësim i cili gjithnjë po na kushton shumë shtrenjtë. Çdo ditë po kemi pengesa gjatë ekzekutimit të punëve për shkak të shpronësimit të cilin po duhet ta bëjmë.

Te mallrat dhe shërbimet i kemi obligime 800 mijë €, por tash i kemi të hyrat vetanake dhe ato do t' i përdorim në këtë kod. Nuk është gjendja aq alarmante aq sa thuhet.

Qemajl Mustafa- ju përsërites të gjithëve dhe unë po përgjigjem fillimisht rreth asaj që e tha Zijadini dhe konsideroj se është krejt normale që te mallrat dhe shërbimet dhe te komunalitet dhe te subvencionet për shkak të rritës së Komunës këto kode të jenë më të mëdha. Unë sa për ta ilustruar po i them disa gjëra të cilat po përsërisim shumë herë.

Ne para disa ditë e kemi inauguruar një shkollë të Agrikulturës me shumë hapësirë të gjerë e cila natyrisht se e tërheq nevojën për shpenzim të mallrave dhe shërbimeve, për pastrim të objektit për sigurim të objektit, për punëtorë shtesë në hapësirat ku operon ajo shkollë në aspekte praktike me ato 14 hektarë tokë. Brenda dy-tri ditë do të fillojë punën Gjimnazi i Ri e cila është një shkollë e mirë e cila gjithashtu tërheq nevojën shtesë për shpenzim të mallrave dhe shërbimeve. Kjo është krejt normale dhe nuk kemi aq mjete sa do të duhej për të planifikuar.

Sa i përket obligimeve ato nuk janë absolutisht drastike e tha me të drejtë drejtori, sepse janë në rritje të madhe të shpronësimit, sepse shpronësimit janë jashtëzakonisht të kushtueshme, kurse mundësia e të hyrave për t' i dal karshi shpronësimeve është e vogël. Mirëpo kemi intervenime nga qeveria dhe po iu sqaroj se unë e kam një informatë se janë 800 mijë €, obligime të mallrat dhe shërbimet, por ndoshta mund të jenë edhe më shumë. Te investimet kapitale, borxhet janë afër 700 mijë € dhe në përgjithësi janë 1

milion e 700 mijë, kurse te subvencionet dhe komunalit janë rreth 500 mijë €, do të thotë janë 2 milion. Nëse këtij 2 milioni i hiqen 1 milion i cili është i miratuar nga Kuvendi i Kosovës me rishikim të buxhetit për KK të Gjilanit (këto janë për investime kapitale), atëherë mbesin obligime 800 mijë €, por nëse kësaj i hiqen edhe një kërkesë që unë ia kam bërë qeverisë dhe shumë shpresoj që ta na e kthej parane që ne e kanë marrë vendimet e gjykatave e që janë mbi 600 mijë €. Te Mirusha i kemi 400 mijë€, mirëpo 500 mijë na janë ndarë më herët për shpronësime, 100 mijë janë shpenzuar deri më tash dhe janë edhe 400 mijë €. Në vijim të fjalës së tij kryetari vazhdoi për të dhënë edhe sqarime për rrjedhën e parasë sipas çdo kodi edhe atë për çdo detal.

Ne nuk jemi keq, por duhet ditur se Komuna gjithmonë do të ketë obligime, sepse kemi të bëjmë me agjencion shpenzues, kemi të bëjmë me institucion të Komunës. Obligimet krijohen, mandej kompensohen .

Abdyl Aliu- m' u duk nënçmuese kur kryetari më tha drejtoju Zijadini se ai kupton! Po theksoj, se kuptoj edhe unë dhe unë punoj me milion jo të Komunës, por të kompanisë sime e cila është rentabile. Kjo është një dëshmi se edhe unë kuptoj!

Izmi Zeka- është llogaritur nga kryetari se Zijadini është ekspertë i çështjeve ekonomike, është një gabim teknik të kërkojmë falje!

Zijadin Maliqi- në fund të fjalimit kryetari the se në vitin 2008, ne e kemi marrë qeverisjen me 300 mijë € obligime. Nuk është ashtu, por është e kundërta, sepse kanë qenë mbi 300 mijë €, të cilat kanë mbetur për pa u shpenzuar, do të thotë është e kundërta e asaj që e tha kryetari. Nuk ka pasur obligime, por kanë mbet mjetë mbi 300 mijë € të pa shpenzuara. Tjetër asnjëherë në këtë Kuvend, nuk kam diskutuar në aspektin politik, por jam munduar në mënyrë profesionale ta jap mendimin tim, sepse buxheti është i joni i Komunës dhe ne jemi munduar në mënyrë shumë transparente t' i japim vërejtjet tona.

Arben Maliqi- nëse e bëjmë një krahasim në mes të buxhetit të vitit 2013 dhe atë të 2014 shihet se është një buxhet shumë modest, sepse një rritje 3.2% është një buxhet i skamjes, mirëpo nuk kemi mundësi të tjera. Unë e shfrytëzoj rastin dhe e lus, kryetarin dhe drejtorin dhe të gjithë të pranishmit që të bëjnë një planifikim sa më të mirë për sportin shkollor. Është mirë të bëhet një planifikim një ndarje për sportin shkollor. Këtë po them se shumë sportistë, shumë emra të mëdhenj të sportit dalin nga sporti shkollor, prandaj është mirë që të planifikohet një buxhet që në mënyrën më të mirë t' i krijojmë kushte fëmijëve tanë për ta zhvilluar veprimtarinë e vetë dhe të largohen nga gjërat e këqija. Unë iu lus të gjithëve që në këtë pikë të jemi unanim dhe ta miratojmë këtë buxhet.

Izmi Zeka- kush për aprovim të pikës 2.1?

Aprovohet pika 2.1 e rendit të punës: Propozim Buxheti i Komunës së Gjilanit për vitin fiskal 2014 dhe vlerësimet e hershme për vitet 2015-2016, me 18 vota të anëtarëve të Kuvendit, 13 ishin kundër, kurse 5 abstenime.

2.2- Draft Rregullorja për implementimin e tatimit në pronë për vitin fiskal 2014,

Nuhi Nuhiu- sa i përket Rregullores për tatim në pronë nuk ka ndryshime, sepse komisioni ka punuar një kohë të gjatë ka dalë në terren dhe ka bërë verifikime dhe gjendja i ka dalë e tillë dhe si përfundim kjo rregullore është njëjtë me rregulloren e vitit 2013.

Zijadin Maliqi- grupi i ynë e ka analizuar këtë draft- rregullore dhe propozim i yni është që duke marrë parasysh që norma tatimore është e caktuar nga niveli qendror dhe nuk mund të ndryshojmë asgjë të norma tatimore, kemi propozim që te baza tatimore të kemi një zbritje edhe atë deri në 20% për të gjitha kategoritë.

Unë jam i mendimit se inkasimi do të jetë shumë më i mirë me një zbritje të tillë të bazës tatimore.

Vërejtje tjetër është zonat të cilën vërejtje e kam dhënë edhe vitin e kaluar, por edhe njëherë po e përsëris. Te zona e parë nuk është e qartë se cilat rrugë përfshihen si p.sh rruga “Haqif Tetova”, thuhet një pjesë dhe nuk është e precizuar se cila është ajo pjesë?

Duhet të precizohet se cila është ajo pjesë.

Mandej thuhet zona e dytë dhe e tretë dhe thuhet përfshin pjesët e qytetit dhe e njëjta ka qenë edhe vitin e kaluar dhe ju e keni pranuar se është gabim dhe është aprovuar me këtë vërejtje, por përsëri ka mbetur ashtu. Duhet të dihet se cila pjesë është në zonën e dytë dhe cila në zonën e tretë. Duhet të precizohet mirë se cila është pjesa e dytë dhe cila zona e tretë.

Nuhi Nuhiu- sa i përket zbritjes 20% në mënyrë lineare si po e thotë Zijadini, kjo nuk mund të kalon? Nëse e bëjmë një zbritje të tillë, atëherë e bëjmë një shkelje të rëndë, sepse edhe objektet e banimit edhe ato industriale nuk lejohet. Në bazë të kontratave në bazë të gjendjes që e kemi në terren është nxjerr vlera e objekteve. Nuk mund as për qejf as për hir të dikujt ta bëjmë 20%.

Te zonat është e precizuar mirë, ajo që nuk është në zonën e parë është në të dytën dhe këto i keni në mënyrë detale se cilat rrugë përfshihen në zonën e dytë.

Zijadin Maliqi- te zbritja e bazës tatimore, Kuvendi e nxjerr atë vendim dhe askush tjetër dhe ne e kemi bërë këtë bazë. P.sh, 550 € për banesa apo 500 € për shtëpitë. Pse nuk ka mundësi ta bëjmë një zbritje 20%? Prej 500 €, zbret në 400 dhe kështu e stimulojmë qytetarin për ta paguar tatimin në pronë. Kjo është e ligjshme dhe ka mundësi dhe nuk duhet t’i thuhet Kuvendit që nuk ka mundësi të bëhet zbritje.

Te zonat e thash mirë thotë rruga “Haqif Tetova” një pjesë, por cila është ajo pjesë dhe Haqif Tetova dhe thotë edhe pjesa tjetër, prapë nuk e dimë cila është pjesa tjetër?

Zona e 4 dhe 5 janë të precizuara mirë dhe për këto dy zona nuk thash asgjë, por duhet të precizohen zona e dytë dhe e tretë dhe të dallohen mirë cila është zona e dytë dhe cila zona e tretë? Shikoni mirë këto gjëra dhe e sheh se nuk jemi gabim, por ju jeni gabim.

Qemajl Mustafa- me Ligjin mbi tatimin e pronës mekanizmi për vlerësim është një komision në nivelin lokal i cili komision në mënyrë profesionale, autonome e bënë vlerësimin e pronës, e bënë vlerësimin e çmimit të tregut në momentin e vlerësimit për zonën e caktuar.

Nëse dikush thotë (Zijadini), po ndërhyjmë tash dhe po e ulim tash bazën tatimore, atëherë në fakt po ia cenojmë autonominë edhe profesionalizmin atij komisioni i cili është i vetmi mekanizëm me ligj i besueshëm për ta bërë një punë të tillë. Nuk mundemi me një vendim politik atij komisioni t' i cenojmë punën dhe profesionalizmin?

Zijadin Maliqi- unë nuk e cenoj punën e Komisionit dhe ashtu është nëse komisioni e bën vlerësimin duke dal shtëpi më shtëpi dhe ne këtë e kemi bërë edhe kur kam qenë unë.

Ju po e shihni zona e parë 500 €, është sikur ajo shtëpia moderne me të gjitha të mirat, sikur ajo që është para rrënimit. Kjo nuk qëndron, por nëse dilet dhe bëhet vlerësimi shtëpi për shtëpi ajo është punë e komisionit dhe unë nuk dua të ndërhyjë në ato çështje, por e vërejtja është kjo është vetëm sipas zonave.

Jo për marketing politik dhe e shihni se ne edhe para një viti kur është aprovuar Rregullorja e tatimit në pronë këtë e kemi kërkuar.

Nuhi Nuhiu- kur është çështja e anketimi, z. Zijadini ka qenë drejtor i këtyre anketuesve, ata punojnë në terren dhe e bëjnë anketimin e objekteve. Ne me ligj nuk e kemi të lejuar ta bëjmë vlerësimin në bazë të kualitetit të ndërtimit të objektit. Kjo edhe për mua ndoshta nuk është në rregull, por ne nuk nxjerrim ligje, ato nxirren në Kuvendin e Kosovës.

Të banuara të pabanuara ato sillen në drejtori dhe mandej kategorizohen, kurse të tjera jo .

Izmi Zeka- kush për aprovim të pikës 2.2. të rendit të punës.

Aprovohet pika 2.2 e rendit të punës: Draft Rregullorja për implementimin e tatimit në pronë për vitin fiskal 2014, me 21 vota të anëtarëve të Kuvendit, kurse të tjerët abstenojnë.

2/3- Propozim vendimi për lejimin e ridestinimit të mjeteve financiare,

Xhemajl Salihu- për vitin 2013 kemi planifikuar për ta blerë një autoambulancë për nevoja të QKMF-së dhe një veturë për nevoja të patronazhit. Mirëpo gjatë këtij vitit ne e kemi marrë si dhuratë një autoambulancë dhe një veturë nga Caritasi i Kosovës dhe në këtë mënyrë ka pushuar nevoja për ato dy auto vetura. Ato mjete të cilat kanë qenë të planifikuara, prandaj kërkoj nga anëtarët e Kuvendit që ato mjete t' i bartim në rregullimin e infrastrukturës, sepse kemi shumë nevojë për renovim të objekteve shëndetësore.

Izmi Zeka- të deklarojeni se kush është për aprovim të pikës 2/3 të rendit të punës

Aprovohet pika 2/3 e rendit të punës: Propozim vendimi për lejimin e ridestinimit të mjeteve financiare, me të gjitha votat e anëtarëve të pranishëm të Kuvendit

2/4-Strategjia Lokale kundër dhunës në familje 2013-2018,

Izmi Zeka- këtë material, anëtarët e Kuvendit e kanë pasur, por ne e kemi pasur vetëm një vërejtje në KPF (që termi konflikt të zëvendësohet me termin luftë). Nga përgjegjësit e kësaj strategjia ishte përgjigja se është marrë parasysh kjo vërejtje dhe është zëvendësuar termi konflikt me atë luftë.

Ju lutem të deklarojeni se kush është për aprovim të kësaj strategjie?

Aprovohet pika 2/4 e rendit të punës: Strategjia Lokale kundër dhunës në familje 2013-2018, me të gjitha votat e anëtarëve të Kuvendit.

2/5- Propozim vendimi për lejin e këmbimit të pronës së paluajtshme komunale me pronën e paluajtshme private për nevojat e rrugës publike “Jugu I-pjesa e II-të, (rasti i familjes Haziri),

Izmi Zeka- i autorizuar nga ana e drejtorit të Kadastrit për ta sqaruar këtë propozim-vendim është zyrtari për pronë në këtë drejtori z. Sali Fazliu.

Sali Fazliu- z. Fazliu këtë propozim-vendim e sqaroi në mënyrë detale, por të gjithë anëtarët e Kuvendit e kanë marrë këtë arsyetim me shkrim.

Arben Mehmeti- ne për këtë pikë kemi debatuar edhe në KPF në të cilin komitet kemi pasur rezerva për këtë propozim, sepse edhe pse është me interes për Komunën për ta zgjidh këtë problem, por të lihet për t’ u bërë kjo zgjidhje në seancën e fundit është joserioze! Janë disa rregulla që në gjashtëmujorin e fundit KK nuk duhet të merret me disa probleme të pronave, sepse mund të na del ndonjë parregullsi në ndërkohë.

Unë në emër të LDK-së jam që kjo pikë e rendit të punës të shtyhet për seancën e mandatit të ardhshëm, sepse nuk është urgjente dhe nuk e pengon askënd nëse shtyhet për seancën e mandatit të ardhshëm. Në kohën kur dikush është shumë i interesuar për të nxituar me këtë propozim, atëherë është çështje për të pasur dilema.

Ne jemi për ta zgjidhur këtë problem, por jo në seancën e fundit Komuna të bëjë ndërrim të pronave shkel e shko!

Qemajl Mustafa- sa për informacion po iu them se familja Haziri i ka pasur aty 45-50 ari pronë, prej të cilave 15 ari (ndoshta nuk jam shumë i saktë) ia kemi kompensuar me para me një vlerësim edhe për mua shumë të ulët. Ajo tokë ka qenë në zonën e dytë dhe më duket se është vlerësuar nga 8 mijë € për ari. Duhet ta vini veten në këtë pozicion, sepse toka e tyre fillon nga rrethrotullimi dhe deri te rruga e Zabelit dhe është në tërësi nëpër arën e tyre. Bëheni ju në atë pozitë të atij pronari dhe po pyes a do ta kishit dhënë ju atë tokë në atë vend për 8 mijë € për ari? Në fazën e ardhshme kur i kemi marrë edhe 30 ari të tjerë, ata kanë kërkuar që mos t’ i bëhet kompensimi me të holla, sepse kanë qenë shumë të dëmtuar, por kanë kërkuar t’ iu epet tokë mundësisht të kualitetit të njëjtë!

Po theksoj se kjo është një familje e mrekullueshme operuese, familje plotësisht tolerante e cila ka ardhur në Komunë dhe kanë kërkuar që rruga të rregullohet, por mundësisht të mos na bëhet vonesë. Ideja ka qenë që ne të bëjmë këmbim të tokave me hapësirën e çerdhes e cila i ka 90 ari dhe këto 30 ari t’ ia kthejmë atyre aty pranë. Mirëpo një gjë e tillë nuk ka ndodhur, është shpall ajo tokë në likuidim, por ne po bëjmë përpjekje për ta kompensuar dhe për ta kthyer dhe çerdhen për ta bërë pasuri të Komunës nëse ia dalim. Nuk ka mbetur variant tjetër për t’ i dal karshi kësaj familje, sepse jemi të zvarritur dhe të koritur në një mënyrë që t’ ia kompensojmë tokën dhe nuk ka ide tjetër, përveç ajo pjesa që po mbetet jashtë Tregut të Gjelbër, ajo pjesa që ka mbetur për ndërtim e që edhe këtu është për ndërtim dhe në njëfarë mënyre është një me një dhe edhe aty është për ndërtim dhe nuk mendoj që vlerësuesi kur të vijë do t’ i vlerësojë ndryshe.

Arben Mehmeti- qëllimi i jonë është që kjo çështje të definohet njëherë e përgjithmonë mirë. Në momentin kur ne po merremi me shqyrtimin e kësaj çështje mund të ketë dilema edhe ligjore, sepse vlerësimi merret në një situatë tjetër, mandati i Kuvendit ndryshon dhe kjo eventualisht mund të sjell paqartësi dhe probleme ligjore funksionale të qeverisjes lokale. Qëllimi jonë është që të mos kemi këtu dilemë ! Çka e pengon kryetarin e Komunës për ta lënë këtë në mandatin e ardhshëm?

Izmi Zeka- për të satën herë po e përsëris, se nëse ne marrim vendim kundërligjor, MPL- ja na e kthen atë vendim. Kërkoj që të mos humbim kohë rreth aspektit ligjor.

Qemajl Mustafa- po e sqaroj pse nuk duhet të ndalemi? Kjo është seancë normale e punës dhe do të duhej të vazhdojmë kështu me punë. Ne vija dhe prerje me brisk nuk mund të bëjmë në fund të mandateve. Janë obligime të krijuara, janë procese të cilat vazhdojnë përtej këtij mandati etj.

Sokol Haziri- në parim ne jemi për zgjidhjen e të gjitha problemeve, por respektimi i ligjit është kusht i domosdoshëm dhe siç e dimë prona është e shenjtë. Nuk mundet Komuna, as shteti dhe askush të silltet me papërgjegjësi ndaj pronës private. Unë vetëm kërkoj që të zbatohen të gjitha ato që janë obligime ndaj qytetarëve të komunës së Gjilanit. Mirëpo për hir të korrektësisë dhe për hir të opinionit dua të sqaroj se të kompensuarit ishin me mbiemrin Haziri, unë nuk kam lidhje familjare me këtë familje dhe nuk kam asnjë lidhje gjaku me këtë familje. Sa për sqarim e dhashë këtë informacion!

Elisah Ymeri- unë po ia përkujtoj Arben Mehmetit se kjo seancë është e zakonshme, kryetarin nuk do ta ndërrojmë këtë do ta kemi edhe 4 vitet e ardhshme dhe nuk është problem në këtë seancë apo tjetër ne kështu do të punojmë në interes të qytetarëve.

Izmi Zeka- kush është për aprovim të pikës 2/5?

Aprovohet pika 2/5: Propozim vendimi për lejimin e këmbimit të pronës së paluajtshme komunale me pronën e paluajtshme private për nevojat e rrugës publike “Jugu I-pjesa e II-të, (rasti i familjes Haziri), me të gjitha votat e anëtarëve të pranishëm të Kuvendit.

2/6- Propozim vendimi për lejimin e ri-rregullimit të kufijve të ngastrave kadastrale komunale me ato private për nevojat e rrugës publike,

Izmi Zeka- ky propozim-vendim ka të bëjë me pronë përsëri, prandaj fjalën përsëri do ta ketë zyrtari për pronë Sali Fazliu.

Sali Fazliu- arsyetimin e këtij propozim vendimi të gjithë anëtarët e Kuvendit e kanë pasur në materialet e tyre të seancës, por z. Fazliu edhe gojarisht e elaboroi në seancë.

Arben Mehmeti- nga vërejtjet që i kemi pasur për drejtorinë përkatëse të cilat i kemi thënë edhe në KPF, po e përsërisim se është jo serioze që neve të na drejtohet një shef i një sektori, kurse drejtori i drejtorisë nuk është i pranishëm. Është obligim i drejtorit të drejtorisë të na paraqet këso çështje që janë me interes të qytetarëve.

Sa i përket lëndës ne e kemi thënë edhe në komitet se një dokument që ju e keni ofruar para anëtarëve të Kuvendit shkruan si në vijim: ” është konstatuar se në një pjesë të kësaj ngastre ka uzurpim në objekt prej 19m²”. Dokumenti që ju na e keni dërguar neve shkruan se kemi të bëjmë me një uzurpim nga një person të cilin nuk e njohim! Ne tash si Kuvend të merremi me legalizim të uzurpimit është shumë joserioze, mirëpo për juve si duket dita e fundit e kësaj qeverisje nënkupton për t’ i mbuluar të gjitha paligjshmëritë. Po e sqaroj se na keni sjell dokument ku bëhet fjalë për uzurpim dhe këtu kërkon për t’ u bërë ndryshim të pronave gjëja se në emër të pronës publike dhe kështu me radhë. Kjo është tepër jo serioze dhe është edhe shkelje e ligjeve në fuqi dhe që është standard për një qeverisje normale.

Ejup Haziri-pasi që u përmend se ky propozim i ka kaluar të gjitha procedura duke filluar nga Komiteti për Planifikim, mandej në KPF, ne realisht jemi për aprovim të këtij propozim-vendimi. Këtu bëhet fjalë për hapjen e një rruge, ose lehtësimin e jetës të banorëve në atë pjesë të qytetit.

Ndërsa një propozim në mes të rreshtave, duhet bërë edhe një zyre të protokollit, sepse për atë kemi nevojë.

Arben Maliqi- unë e kam përmend para disa muajve se ajo shtëpi me 12m², ajo paraqet rrezik, sepse është e demoluar. Aty futen narkomanët, aty ka papastërti dhe jo që duhet të merret vetëm ajo pjesë, por duhet të demolohet edhe Enti i Statistikës, sepse aty banojnë vetëm dy familje të cilave dueht dhënë banesë për t’ u liruar ajo rrugë dhe qytetarët të kenë qasje të lirë. Më vejnë mirë që po ndodh tash, sepse qysh moti ka qenë desh të kryhet kjo procedurë.

Izmi Zeka- të deklaroheni se kush është për aprovim të pikës 2/6 të rendit të punës?

Aprovohet pika 2/6: Propozim vendimi për lejimin e ri-rregullimit të kufijve të ngastrave kadastrale komunale me ato private për nevojat e rrugës publike, me 19 vota të anëtarëve të Kuvendit, kurse 10 ishin kundër.

2/7- Propozim vendimi për lejimin e këmbimit të pronës së paluajtshme komunale me pronën e paluajtshme të Bashkësisë Islame-Xhamia e Deremahallës,

Sali Fazliu- edhe pikën 2/7 e elaboroi zyrtari për pronë Sali Fazliu, të cilin arsyetim anëtarët e Kuvendit e kanë në materialet e tyre.

Arben Mehmeti- në parim ne e mbështesim, por unë kam informata nga banorët që jetojnë aty afër, në pjesën ku po planifikojmë t’ ia japim xhamisë, ka dilema se mos është aty nën tokë kanalizimi i qytetit dhe mos po lejojmë që të bëhen ndërtime mbi kanalizim. Për këtë arsyeje kërkoj që të kemi kujdes dhe a lejohen ndërtimet mbi kanalizim?

A janë siguruar gjërat që mos të lejohet të ndërtohet mbi kanalizim, sikurse ka ndodhur në të kaluarën. Është mirë këtë çështje ta definoni mirë!

Sali Fazliu- në flet poseduese ajo pjesë figuron si përrua dhe në të kaluarën ajo ka qenë një përrua i cili ka ardhur që nga Stacioni i Autobusëve dhe është derdhur në Lumin

Mirusha. Mirëpo ajo pjesë tash është mbuluar dhe qëndron ajo që aty është një kanalizim i qyteti, por me vendosjen e njeëve sanitare nuk do të ketë ndërhyrje në kanalizim.

Arben Maliqi-unë nuk e di pse po diskutojmë, sepse besoj se nuk ka asnjë anëtarë që nuk e voton, por iu lus që kur të jenë edhe puna për institucionet shkollore, për objekte sportive të jemi të gjithë unanim si do të jenë tash. Nuk ka nevojë ta zgjasim më shumë të gjithë do të jemi unanim.

Elisah Ymeri- unë e dëgjove shefin e grupit parlamentar të LDK-së i cili tha se kemi shqetësime të qytetarëve. Unë mendoj se obligim i yni është që të shkojmë aty ku janë shqetësimet.

Abdyl Aliu- bëhet fjalë për lagjen time aty ku jetoj që nga fëmijëria, prandaj dua ta di dhe po pyes se a ekziston harta e kanalizimit për atë pjesë? Aty ka kanalizim dhe ne jemi për aprovim të kësaj pike të rendit të punës, por më vonë do të biem në kundërshtim, sepse ata bëjnë kërkesë për ndërtim. Me ligj nuk lejohet ndërtimi mbi objektet e infrastrukturës nëntokësore. Ne jemi për t'ia dhënë xhamisë atë pjesë, por kur të vije çështja e ndërtimit do të paraqiten probleme!

Qemajl Mustafa- unë mirëprita shumë këtë sugjerimin e Abdylit, por në këtë rast po bëhet kompensimi i tokave dhe të jetë ajo pjesa e xhamisë ku do të ndodhë ndonjë shfrytëzim i lehtë, por duke mos e cenuar funksionimin. Xhamia po kërkon që vetëm nyjat sanitare të rregullohen, sepse brenda nuk kanë kushte normale. Ne me mirëkuptim me xhaminë e rregullojmë, por po e them se edhe po të mos kishin kërkuar ata kompensim të pronave, i sigurt jam që Kuvendi do ta kishte aprovuar!

Izmi Zeka- Kush është për aprovim të pikës 2/7 ?

Aprovohet pika 2/7: Propozim vendimi për lejimin e këmbimit të pronës së paluajtshme komunale me pronën e paluajtshme të Bashkësisë Islame-Xhamia e Deremahallës, me të gjitha votat e anëtarëve të Kuvendit të pranishëm në sallë të Kuvendit.

2/8- Propozim vendimi për ndërrimin e destinimit të PZHU-ndërtimi i Xhamisë në Lagjen “Z.S.Agës”.

Izmi Zeka- të gjithë anëtarët e Kuvendit janë të njoftuar me këtë rast, prandaj iu lus që të deklaroheni se kush është për aprovim të pikës 2/8?

Aprovohet pika 2/8 e rendit të punës: Propozim vendimi për ndërrimin e destinimit të PZHU-ndërtimi i Xhamisë në Lagjen “Z.S.Agës”, me të gjitha votat e anëtarëve të pranishëm të Kuvendit.

2/9- Marrëveshja e Mirëkuptimit në mes të Komunës së Gjilanit, Qendrës Socio-Kulturore “Don Bosko” dhe Kryefamiljarit z.Selim Ramadani nga Gjilani,

Qemajl Mustafa- gjatë vlerësimit të pronave për Qendrën “Don Bosko” i kemi paguar vlerësuesit në Prishtinë 44 mijë €. Mirëpo në ato pjesë paska qenë një familje e strehuar në një përdhese jashtë objektit të kësaj qendre. Tash ka lind nevoja për ta zhvendos dhe për mos ta bërë këtë familje rast social dhe të pastrehë jemi marrë vesh me komunitetin e “Don Boskos” që të na kthehet gjysma e atyre investimeve, do të thotë ta marrim barrën 50:50 % dhe 22 mijë € në dy këste janë zotuar se do t’ i kthejnë në Komunë dhe ne t’ i destinojmë ato mjete për ta ndërtuar shtëpinë e këtij familjari.

Arben Mehmeti-mua po më duket se është bërë një lloj tregtie me këtë rast, sepse nuk e dimë a ka përfunduar kjo çështje apo ne tash jemi duke marrë vendim? Pyetja është a ka përfunduar kjo punë apo do të përfundojë në të ardhmen?

Qemajl Mustafa- është thënë kështu: “ në çastin kur Komuna e zhvendos familjen prej asaj banese, Don Bosko i paguan 50% të obligimeve dhe 11 mijë € kanë kaluar në llogari të Komunës, kurse 11 mijë të tjera do të alokohen pas gjysmës së tetorit.

Izmi Zeka- kush është për aprovim të pikës 2/9 të rendit të punës?

Aprovohet pika 2/9 e rendit të punës: Marrëveshja e Mirëkuptimit në mes të Komunës së Gjilanit, Qendrës Socio-Kulturore “Don Bosko” dhe kryefamiljarit z.Selim Ramadani nga Gjilani, me të gjitha votat e anëtarëve të Kuvendit të pranishëm në sallë të Kuvendit.

3. Të ndryshme,

Izmi Zeka- nën të ndryshme e kemi një Raport të dëmeve dhe viktimave të luftës gjatë vitit 1999. i cili dokumentacion është mirë të vijë në Komunë, pastaj të dërgohet në institucionet përkatëse.

Sokol Haziri- mua më duket se nuk mund të prolongohet në pafundësi çështja e dëmeve të luftës, unë jam për atë që të mos prolongohet, por organeve kompetente për këtë çështje e që është gjyqësori dhe prokuroria t’ iu lihet në dispozicion material. Ne si Kuvend mund të debatojmë kur të duam. Ky komision, këtë material ta dorëzojnë aty ku është vendi, kurse ne si Kuvend jam për atë që ta debatojmë në kohën e duhur.

Ejup Haziri- komisioni për të cilin po bëjmë fjalë ka punuar në një periudhë katër vjeçare dhe në këtë Komision janë të përfaqësuara të gjitha partitë politike që janë në Kuvend. Puna është kryer, është përmbyllur dhe dosja është e kompletuar. Ajo dosje duhet vetëm të shtypet dhe me përgjegjësi e them se askush nuk e ka dokumentacion e tillë të kompletuar si e ka ky Komision i KK – së Gjilanit. Nuk kemi nevojë ta prolongojmë, por ta kryejmë procedurën si duhet, sepse këtu nuk ka shpërblim për asnjë subjekt politik, nuk ka punë për subjekte politike, por bëhet fjalë për punën e përbashkët të gjitha subjekteve politike.

Izmi Zeka- Komisioni është formuar para 4 viteve dhe anëtarë janë Sami Hoxha, Sami Ahmeti, Rasim Shabani, Xhemajl Zeqiri dhe Ejup Haziri. Ky komision ka punuar 4 vjet dhe tash është një mundësi e mirë për të u aprovuar, sepse i ka kaluar të gjitha procedurat.

Sokol Haziri- unë mendoj se nuk është kjo çështje e partisë ose e fushatave dhe nuk është çështje e vlerësimit të Kuvendit, por është çështje e organeve të ndjekjes, organeve gjyqësore. Ne si Kuvend kemi mundësi t' i japim të drejtën atij Komisioni për ta dorëzuar materialin në organet përkatëse. Çdo ngecje në këtë drejtim është papërgjegjësi e jona!

Izmi Zeka- nën të ndryshme e kemi edhe një pikë të rendit të punës: **Vendimi për caktimin e interesit publik për hapjen e rrugës.**

Lokacioni i caktuar për interes publik sipas nenit 2 të këtij vendimi lehtëson qarkullimin e qytetarëve me zona të tjera të qytetit dhe me objektet publike (Stacionin e Autobusëve, Spitali Regjional, Shkollën Filllore “Thimi Mitko”, Qendrën për Punë Sociale dhe me objektet tjera administrative komunale.

Aprovohet **vendimi për caktimin e interesit publik për hapjen e rrugës, me të gjitha votat e anëtarëve të Kuvendit.**

Bujar Mevzadi- unë dola për t' i dhënë një përgjigje zonjës Bahrie Veseli e cila i pat tri shqetësime për tri arsime të cilat fare nuk duhet shqetësuar, sepse nuk është rasti ashtu si thuhet. Është fjala për Dritë Kallabën e cila i ka shkel rregullat e shkollës dhe të cilën drejtori e ka dënuar dhe kjo është problematika e saj.

Mandej është fjala për Luljeta Hoxhën e cila ka pasur performancë të dobët nga drejtori i shkollës, mandej ka pasur vlerësim negativ edhe nga inspektorët e arsimit dhe ne në bazë të rekomandimit të inspektorëve të arsimit e kemi suspenduar me pagesë dhe ia kemi ofruar një vend të punës në Bibliotekën e qytetit. Kjo është e tërë me arsimtaren Luljetë!

Sa i përket Rexhie Bllacës është fjala për një aktiviste të PDK-së dhe nuk ka nevojë për shqetësim të anëtares së Kuvendit zonjës Bahrie, sepse që nga ardhja në pushtet të PDK-së ne kemi krijuar rregulla të qarta në të gjitha shkollat. I them zonjës Bahrie se ka kaluar koha (kur ajo personalisht ka vendosur për arsime dhe në çfarë mënyre janë bërë punësimet.

Sa i përket vërejtjes së profesores Sarandë ne i kemi ftuar drejtorët e shkollave dhe i kemi dhënë sqarime që gjatë fushatës të kenë kujdes të veçantë. Çdo rast që e ka dhe çdo rregull që keqpërdoret le të urdhërojë zonjusha Sarandë në DKA dhe ne në pajtim me ligjin do të marrim masa. Këto ishin përgjigjet e mia dhe përsëri iu falënderoj për vërejtjet dhe sugjerimet.

Me këto debate dhe vendime seanca e njëmbëdhjetë i përfundoi punimet

Procesmbajtësi

Sali HASANI

Kryesuesi i Kuvendit

Izmi ZEKA